

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve, Shoqatat e Prokurorëve dhe gjyqtarëve refuzojnë tryezën me Ramën: Çështja ndodhet në Kushtetuese - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/shoqatat-e-prokuroreve-dhe-gjyqtareve-refuzojne-tryezen-me-ramen-ceshtja-ndodhet-ne-kushtetuese/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:53:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 07:48:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7d7becdaa9e3c6d3d69c544a1df57659243bada223157cd51501a72738e1a779
TEKSTI	e82e36e9296ae2194827f1944f21755571b91fed2e25ad122a95534d6bc40af4
PAMJA	07e5bcafff03949d6e101fd9d41e8dbd50591c963ceb0d5176855ac379f772bc7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	76198a963694ce2bb7ab167e3c06aa67bc6cb7890aa8fef4592ab377491862fa
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/76198a963694ce2bb7ab167e3c06aa67bc6cb7890aa8fef4592ab377491862fa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Edi Rama Këshilli i Sigurisë Kombëtare Inteligjenca Artificiale Lufta në Iran

AKTUALITET | VENDI

Pagat e magistratëve, Shoqatat e Prokurorëve dhe gjyqtarëve refuzojnë tryezën me Ramën: Çështja ndodhet në Kushtetuese

28 Shtator 2026 | 09:48

Shoqatat e prokurorëve dhe gjyqtarëve kanë njoftuar se refuzojnë të zhvillojnë një dialog me kryeministrin Edi Rama lidhur me çështjen e pagave të magistratëve. Shoqata e Prokurorëve shprehen se konsiderojnë dialogun institucional një instrument të rëndësishëm për adresimin e këtyre çështjeve dhe mbetet e hapur për një komunikim konstruktiv me institucionet.

Megjithatë, duke pasur parasysh se çështja objekt i konsultimit lidhet drejtpërdrejt me një proces kushtetues të iniciuar nga shoqatat e magistratëve pranë Gjykatës Kushtetuese, ata kanë kërkuar që një tryezë e tillë të zhvillohet pas një qëndrimi të Gjykatës Kushtetuese mbi çështjen. Sipas tyre pas një qëndrimi nga Gjykata Kushtetuese, dialogu institucional mund të zhvillohet mbi një kuadër më të qartë dhe duke respektuar plotësisht rolin dhe kompetencat kushtetuese të Gjykatës.

"Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë ju falënderon për përcjelljen e ftesës së Kryeministrit për zhvillimin e një takimi lidhur me çështjen e pagave të magistratëve dhe vlerëson gatishmërinë e shprehur për dialog institucional mbi një çështje që lidhet drejtpërdrejt me statusin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Shoqata ka vlerësuar në vijimësi se dialogu ndërinstitutional, kur zhvillohet në respekt të rolit dhe kompetencave kushtetuese të secilit pushtet, përbën një instrument të nevojshëm për identifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Në këtë këndvështrim, çështja e trajtimit financiar të magistratëve nuk duhet parë e shkëputur nga tërësia e garancive që mundësojnë ushtrimin e pavarur, të përgjegjshëm dhe cilësor të funksionit gjyqësor.

Megjithatë, në rrethanat aktuale, kur çështje që lidhen drejtpërdrejt me standardin kushtetues të pagës së magistratëve janë bërë objekt i një procesi tashmë të iniciuar pranë Gjykatës Kushtetuese, Shoqata vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme pjesëmarrja e saj në një diskutim institucional mbi të njëjtën çështje përpara përfundimit të këtij procesi. Vendimmarrja kushtetuese pritet të qartësojë parametrat brenda të cilëve mund të zhvillohet më tej një diskutim i plotë dhe konstruktiv për mekanizmin e trajtimit financiar të magistratëve.

Për këtë arsye, Shoqata çmon se diskutimi i propozuar mund të zhvillohet në një moment të mëvonshëm, pasi të jetë qartësuar kuadri kushtetues përkatës. Ky qëndrim nuk përbën

LAJMI I FUNDIT

09:50 Irani këmbëngul te diplomacia pas refuzimit të planit nga Trump: Nëse Teherani nuk tregon, askush nuk do të tregtojë

09:42 Ministri i Jashtëm polak: Rusisë i mungojnë forcat për një sulm të madh ndaj NATO-s

09:32 Hoxha takim me kryetarin e Komisionit për Çështjet e BE në Bundestag: Gjermania mbështetëse e rrugëtimit evropian

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

09:28 Fitore historike për ekstremitetin e djathtë në Francë, RN e Marine Le Pen siguron 14 vende në Senat

09:18 Kreu i inteligjencës egjiptiane telefonoi Netanyahu para 7 tetorit, si u injorua paralajmërimi për sulmin e Hamasit

09:17 Konferencë ndërparlamentare për zgjerimin e BE-së, Rama mban fjalën përshëndetëse në Tiranë

TESTIM

terneqje nga dialogu institucional dhe as kuznim te gatshmerise sone per te kontribuar ne diskutime qe synojne perrmiresimin e qendrueshem te funksionimit te sistemit gjyqesor.

Në vlerësimin tonë, një dialog i tillë nuk duhet të kufizohet vetëm në dimensionin financiar të statusit të magistratit, por mund të përfshijë çdo element që ndikon në pavarësinë, eficientë dhe cilësinë e drejtësisë. Garancitë e statusit të gjyqtarit, përfshirë trajtimin financiar, nuk përbëjnë privilegje të një kategorie profesionale, por janë mjete institucionale që duhet të shërbejnë për krijimin e kushteve që gjyqësori t'u ofrojë qytetarëve një shërbim të pavarur, profesional, të paanshëm dhe efektiv.

Në këtë frymë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve mbetet e hapur dhe e gatshme për dialog e bashkëpunim institucional, në një moment të përshtatshëm dhe mbi një bazë kushtetuese të qartësuar, për çështjen e pagave të magistratëve si dhe për çdo çështje tjetër që lidhet me forcimin e cilësisë dhe funksionimit të sistemit gjyqësor në interes të publikut", thuhet në njoftim.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

Hoxha takim me kryetarin e Komisionit për Çështjet e BE në Bundestag: Gjermania mbështetëse e rrugëtimit evropian

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ferit Hoxha priti mëngjesin e kësaj të hëne në Tiranë, Kryetarin e Komisionit për Çështjet e Bashkimit Evropian...

09:32 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Kush janë anëtarët e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (EMRAT)

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, e thirrur nga Presidenti Bajram Begaj në Pallatin e Brigadave, rikthen në vëmendje përbërjen e organit më të lartë...

08:14 | 28/09/2026

AKTUALITET | BOTA | LAJMI I FUNDIT | VENDI

Arrestohet në SHBA 56-vjeçarin shqiptar, akuzohet për abuzim seksual me të mitur

Zyra e Shërbimit Amerikan të Imigracionit dhe Doganave (ICE) në Boston njoftoi arrestimin e një shtetasi shqiptar 56-vjeçar, Hasan Billa, banues në Wolcott, më 3...

22:04 | 27/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: